



Zyra e Kryetarit të Komunës së Klinës

Nr. 06-16139/25

Datë: 02-06-2025

KALENDARI I DËGJIMEVE BUXHETORE ME QYTETARË PËR DRAFT-KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE 2026-2028

Bazuar në LIGJI NR. 03/L-040 PËR VETËQEVERISJEN LOKALE, LIGJI NR. 03/L-048 PËR MENAXHIMIN E FINANCAVE PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË, si dhe UDHËZIMIN ADMINISTRATIV (MAPL) NR.04/2023 PËR ADMINISTRATË TË HAPUR NË KOMUNË, Kuvendi Komunal Klinë në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, grupin punues për organizimin e dëgjimeve buxhetore, si dhe Zyrën për Informim, hapin Dëgjimet Buxhetor për Draft- Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028.

Korniza afatmesme Buxhetore komunale paraqet një përmbledhje të planifikuar të shpenzimeve dhe të hyrave buxhetore për komunën e Klinës për periudhën afatmesme 2026-2028 si dhe shpërndarjen e resurseve financiare nëpër programe komunale sipas prioriteteve të qeverisë komunale të nxjerra nga dokumentet strategjike komunale dhe vendimet e Kuvendit komunal të Klinës. KAB 2026-2028 paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet Buxheti vjetor për vitin 2026. Konsultimi publik është i hapur nga data 28 maj 2025, deri më 24 qershor 2025, dhe takimet do të mbahen sipas këtij kalendari;

Tabela – Kalendari i dëgjimet Buxhetor për Draft- Kornizën Afatmesme Buxhetore;

Nr.	Planifikimi i dëgjimeve buxhetore	Vendi i mbajtjes së dëgjimit buxhetor	Data/dita e mbajtjes së dëgjimit	Koha/ora
1.	TAKIMI I - Salla e Konferencave, në Komunën e Klinës, me Kryetarët e Këshillave të Fshatrave.	Komuna Klinë, Salla e Konferencave.	05.06.2025	10:00
2.	TAKIMI II - SHFMU “Isa Boletini”, në fshatin Poterç i Epërm, më banorët e fshatrave Poterç i Epërm, Poterç i Poshtëm, Drenoc	SHFMU “Isa Boletini”, në fshatin Poterç i Epërm.	05.06.2025	17:00

	dhe Dugajevë.			
3.	TAKIMI III - SHFMU “Azem Bejta”, në fshatin Grabanicë, më banorët e fshatrave Grabanicë, Dollovë, Bokshiq, Këpuz dhe Qeskovë.	SHFMU “Azem Bejta”, në fshatin Grabanicë.	05.06.2025	18:30
4.	TAKIMI IV - SHFMU “Motrat Qiriazit”, në fshatin Zajm, më banorët e fshatrave Zajm, Gremnik, Deiq, Dollc dhe Dresnik.	SHFMU “Motrat Qiriazit”, në fshatin Zajm.	09.06.2025	17:00
5.	TAKIMI V - SHFMU “Avni Zhabota”, në fshatin Shtupel, më banorët e fshatrave Shtupel, Kërrnicë, Binxhë, Grabc, (komunitetin joshumicë).	SHFMU “Avni Zhabota”, në fshatin Shtupel.	09.06.2025	18:30
6.	TAKIMI VI - SHFMU “Tre Dëshmorët”, në fshatin Jashanicë, me banorët e fshatrave Jashanicë, Pogragjë, Dush i Vogël, Resnik, Jelloc, Gjurgjevik i Madh, Ujmirë, Doberdol.	SHFMU “Tre Dëshmorët”, në fshatin Jashanicë.	10.06.2025	17:00
7.	TAKIMI VII – SHFMU “Dëshmorët e Qëndresës”, në fshatin Gllarevë, me banorët e fshatrave Gllarevë, Sferkë, Caravik, Volljakë, Zabergjë, Përçevë.	SHFMU “Dëshmorët e Qëndresës”, në fshatin Gllarevë.	10.06.2025	18:30
8.	TAKIMI VIII - SHFMU “Atë Shtjefën Gjeçovi”, në fshatin Zllakuqan, më banorët e fshatrave Zllakuqan, Berkovë, Ranoc, Leskoc, Nagllavë, Dranashiq, Stupë, Rudicë, Jagodë, Videjë, Krushevë e	SHFMU “Atë Shtjefën Gjeçovi”, në fshatin Zllakuqan.	11.06.2025	17:00

	Madhe dhe Budisalc.			
9.	TAKIMI IX – Shtëpia e Kulturës “Jehona e Dukagjinit”, me temë “Prioritetet e grave dhe të rinjve të komunës së Klinës.	Shtëpia e Kulturës “Jehona e Dukagjinit”, në Klinë, sheshi “Mujë Krasniqi”.	11.06.2025	16:00
10.	TAKIMI X - Salla e Kuvendit Komunal Klinë, takim i përgjithshëm me banorët e Komunës së Klinës, qytetit dhe lagjeve.	Salla e Kuvendit Komunal Klinë, në Klinë.	12.06.2025	10:00

Ftohen të gjitha institucionet komunale, Qytetarët, OJQ-të, Bizneset, Bashkësitë Lokale, Mediat, përfaqësuesit e komuniteteve, të rinjtë, gratë, pensionistët, studentët, komuniteti i biznesit, përfaqësuesit e institucioneve të ndryshme, përfaqësuesit e ndërmarrjeve publike, anëtarë/e të Kuvendit Komunal të Klinës, punonjësit e Komunës, përfaqësuesit e partive politike dhe grupet tjera të interesit që të jenë pjesë e këtyre dëgjimit buxhetore për Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028.

Materiali në formë fizike mund të merret në Zyrën për Punë të Kuvendit, Zyrën e Kryetarit si dhe Zyrën e Drejtorisë së Financave, po ashtu, gjendet edhe në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Klinës si dhe Platformën e Konsultimeve Publike:

Komuna Klinë:

<https://kline.rks-gov.net/konsultimet-publike/>

Platforma e Konsultimeve Publike:

<https://konsultimet.rks-gov.net/consultations.php?InstitutionID=20514&OpenPage=0&ClosedPage=0>

Propozimet e juaja lidhur me këto akte mund t’i dorëzoni me shkrim në Zyrën e Kuvendit, kati I, zyra e dytë, korridori në anën e djathtë si dhe Zyra e Kryetarit, kati II, zyra parë. Gjithashtu, në mënyrë elektronike tek zyrtarët:

1. Vlora Tafili, email: vlora.tafili@rks-gov.net

2. Melihate Behramaj, email: melihate.behramaj@rks-gov.net;

Mirëpresim propozimet dhe sugjerimet e juaja nga data **28.05.2025**, gjatë mbajtjes së dëgjimit dhe deri me datën **24.06.2025** nëpërmes mjeteve elektronike.

Pas përfundimit të fazës së diskutimit publik, propozimet e juaja do të merren në konsideratë nga grupi punues, duke u shqyrtuar në raportin e konsultimit publik si dhe në seancën e radhës të Kuvendit të Komunës konform dispozitave ligjore.

Zyrtarja përgjegjëse për konsultim Publik,
Vlora Tafili

